



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE

Lënda: Njoftim për fillimin e procesit të qiradhënies.

Në zbatim të Vendimit Nr. 373, datë 20.6.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës TIP për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, i ndryshuar, kreu IV “Procedurat që ndiqen për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”, pika 4.1, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural njofton fillimin e procesit për dhënien me qira të tokës bujqësore në pronësi të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për pasuritë me Nr. 810; Nr. 811/1; Nr. 811/2; Nr. 811/20; Nr. 811/21; Nr. 814; Nr. 816/1; Nr. 816/2; Nr. 816/3; Nr. 818; Nr. 821; Nr. 822; Nr. 823; Nr. 826/1; Nr. 826/2; Nr. 827; Nr. 829/1; Nr. 829/2; Nr. 829/3; Nr. 830 dhe Nr. 834/1; Zona Kadastrale Nr. 2570, me vendndodhje në fshatin Malinat, Njësia Administrative Velabisht, Bashkia Berat, qarku Berat”.